



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 4441 prot.

Tiranë më 24.05.2019

REKOMANDIM

Nr. 27, datë 24.5.2019

PËR KONTROLLUESIN "ASSIST SH.P.K",

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "ASSIST SH.P.K",

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 99, datë 27.03.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "ASSIST SH.P.K" (Call Center), me objekt:

- Verifikim i ankesave të paraqitura pranë Zyrës së Komisionerit nga disa shtetas, në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale për qëllime punësimi dhe zbatimi i ligjit nr. 9887/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Hetimi administrativ pranë kontrolluesit, u fokusua në trajtimin e ankesave të paraqitura pranë Zyrës së Komisionerit nga dy subjekte të të dhënave personale (punonjës të "ASSIST SH.P.K"), të cilët denoncojnë kontrolluesin lidhur me procesin për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për kategorinë e subjekteve punëmarrës, gjithashtu dhe në verifikimin e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi gjatë ushtrimit të aktivitetit.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit "ASSIST SH.P.K", konstaton se:

1. Kontrolluesi "ASSIST SH.P.K" ushtron veprimtarinë në fushën e call center (inbound). Në kuadër të marrëdhënies së punës mbledh dhe përpunon disa kategori të të dhënave personale dhe sensitive, për subjektet e të dhënave personale "Kandidatëve për punë" dhe "Punonjës". Konkretisht përpunon të dhëna personale dhe sensitive të administruara nga zyra e burimeve njerëzore në dosjen personale, të dhëna biometrike të gjurmëve të gishtave të punonjësve në kuadër të aksesit në ambientet e punës dhe të dhëna personale të përpunuara në kuadër të sistemit CCTV. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.
2. Në kuadër të trajtimit të ankesës, kontrolluesi "ASSIST SH.P.K" gjatë procesit për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave për kategorinë e subjekteve punonjës ka parashikuar në deklaratën e informimit/pëlqimit mbledhjen/përpunimin e të dhënave personale "të dhënat e gjendjes civile, të dhënat që kanë të bëjnë me familjarët në ngarkim ose me anëtarët e familjes, detajet e llogarisë rrjedhëse bankare dhe të dhëna sensitive që janë të afta të zbulojnë origjinën racore ose etnike, opinionet politike, bindjet fetare ose filozofike ose anëtarësimin në sindikatë si dhe të dhëna gjenetike, biometrike, të dhëna mbi shëndetin ose orientimin seksual.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, kontrolluesi ka detyrim që të përpunojë ato të dhëna që ka të nevojshme për të arritur qëllimin duke respektuar parimin e mbrojtjes së të dhënave personale lidhur me mjaftueshmërinë e të dhënave personale, sanksionuar në nenin 5/1/c të ligjit, në të cilin parashikohet se mbledhja dhe përpunimi i të dhënave duhet të lidhet me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim.

3. Në lidhje me verifikimin e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale gjatë ushtrimit të aktivitetit u konstatua se kontrolluesi "ASSIST SH.P.K", gjatë procesit të përpunimit të të dhënave për kategorinë e subjekteve kandidatë për punë, nuk ka respektuar parimin e mbrojtjes së të dhënave personale lidhur kohën e ruajtjes së të dhënave personale. Të dhënat për këtë kategori subjektësh përpunohen nëpërmjet sistemit elektronik "Directch" që nga koha e fillimit të aktivitetit të kontrolluesit pavarësisht se këto subjekte janë klasifikuar si të papërshtatshëm për të fituar vendin e punës.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në frymën e Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, kontrolluesi ka detyrim që të përpunojë të dhënat personale për aq kohë sa ekziston qëllimi për të cilin janë grumbulluar dhe përpunuar (neni 5/1/d) dhe në momentin që qëllimi ka përfunduar të realizojë shkatërrimin e tyre, në të kundërt përpunimi i mëtejshëm i të dhënave konsiderohet i paligjshëm.

4. Të dhënat sensitive shëndetësore të punonjësve, të administruara nëpërmjet kartelës shëndetësore, ruhen në dosjen personale të çdo punonjësi në ambientet e Zyrës së Burimeve Njerëzore. Këto të dhëna sensitive përpunohen në kundërshtim me parimet dhe rregullat e parashikuara në Udhëzimin nr. 11, datë 08.09.2011 "Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat", i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, punëdhënësi është i detyruar të marrë masa sigurie (neni 27 i ligjit) për mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve që përpunohen në fushën e marrëdhënies së punës, duke i kushtuar vëmendje të veçantë të dhënave sensitive. Të dhënat sensitive duhet të ruhen të ndara nga çdo e dhënë tjetër personale e punonjësit duke vendosur rregulla të posaçme të dedikuara mbrojtjes së të dhënave sensitive dhe shëndetit të punonjësit. Këto të dhëna duhet të mbahen të ndara në mënyrë që mos të lejojnë një konsultim të padëshiruar gjatë aktivitetit të zakonshëm administrativ.

5. Të dhënat biometrike të punonjësve, që administrohen nëpërmjet një sistemi elektronik, në kuadër të hyrje-daljeve në ambientet e kontrolluesit, përpunohen në kundërshtim me parashikimet e Udhëzimit nr. 11, datë 08.09.2011 "Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat", i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet kur përdorimi i të dhënave biometrike nuk është rregulluar nga ligji, kontrolluesi i të dhënave personale (punëdhënësi) duhet fillimisht të njoftojë Komisionerin për qëllimin dhe arsyet e mbledhjes dhe përdorimit të të dhënave biometrike.

6. Kontrolluesi "ASSIST SH.P.K" në kuadër të garantimit të sigurisë së ambienteve ku ushtron veprimtarinë ka instaluar një sistem kamerash CCTV. Kamerat janë pozicionuar në ambientet e brendshme të zyrave në kundërshtim me parashikimin në Udhëzimin e Komisionerit nr.3, datë 05/03/2010 mbi "Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr.11, datë 08.09.2011 të Komisionerit mbi "Përpunimin e të dhënave personale të punonjësve në sektorin privat", i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit vlerëson se instalimi i sistemit të kamerave në ambientet e punës së punonjësve çënon privatësinë e punonjësve dhe është në kundërshtim me parimin e mjaftueshmërisë (neni 5 i ligjit) pasi kamerat duhet të konsiderohen si mjete i fundit për të realizuar qëllimin (garantimin e sigurisë).

Gjithashtu, kontrolluesi nuk kishte realizuar informimin e subjekteve të të dhënave nëpërmjet tabelave informuese mbi prezencën e sistemit të kamerave të survejimit në hyrje të ambienteve, ku ushtron veprimtarinë e tij, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit Nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 të sipërcituar.

Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave personale është një nga detyrimet bazë të kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi nga ana e kontrolluesit mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

7. Kontrolluesi "ASSIST shpk" nuk ka parashikuar politika privatësie në faqen online www.assist.com.al, në kuadër të detyrimit për informim, në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes online në internet, ka detyrimin që të publikojë "Politikat e privatësisë", pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash realizohet nëpërmjet faqes online në internet. Në këtë kuadër, publikimi i "Politikave të privatësisë" përmbush më së miri qëllimin e informimit.

8. Kontrolluesi ka deleguar disa shërbime, konkretisht:
- Shërbimi i sigurisë është deleguar te kompania "MEGAIES.AL" Sh.p.k;
 - Shërbimet financiare janë deleguar te kompania "Mazars" Sh.p.k;
 - Shërbimi i mirëmbajtjes së sistemit elektronik të administrimit të të dhënave të burimeve njerëzore "Directch" (për kategorinë punonjës, kandidatë për punë) deleguar te kompania "Manpower" S.r.l;
 - Shërbimi i asistencës shëndetësore deleguar te mjeku i familjes;

Në kontratën midis kontrolluesit "ASSIST SH.P.K" dhe përpunuesit "MEGAIES.AL SH.P.K", që kryhen shërbimin e sigurisë së ambienteve, nuk parashikohen detyrimet e palëve në kuadër të zbatimit të nenit 20 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi", i ndryshuar.

Në kontratën midis kontrolluesit "ASSIST SH.P.K" dhe përpunuesit "MAZARS SH.P.K", që kryhen shërbimet financiare, nuk parashikohen detyrimet midis palëve sa i përket garantimit të sigurisë së të dhënave personale dhe përcaktimit të kushteve teknike dhe organizative për të siguruar të drejtat e subjekteve të të dhënave personale, në kuadër të zbatimit të nenit 20 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi", i ndryshuar.

Në kontratën midis kontrolluesit "ASSIST SH.P.K" dhe përpunuesit "MANPOWER S.r.l" që kryen mirëmbajtjen e sistemit elektronik të administrimit të të dhënave të punonjësve dhe kandidatëve për punë, nuk parashikohen detyrimet e palëve në kuadër të zbatimit të nenit 20 të Ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit "Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi", i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit e vlerëson si shumë të rëndësishme parashikimin e detyrimeve midis kontrolluesit dhe përpunuesve, në rastet e delegimit të shërbimeve, sa i përket parashikimit të kushteve teknike dhe organizative dhe masave të sigurisë, konfidencialitetit, garantimin e të drejtave të subjekteve dhe se çfarë do të ndodh me të dhënat personale të përpunuara, pas përfundimit të efekteve ligjore të kontratës.

9. Kontrolluesi "ASSIST SH.P.K" ka përbushur detyrimin për njoftim në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Nga analizimi i përmbajtjes së njoftimit rezultoi se kontrolluesi nuk e kishte kryer përditësimin për ndryshim të gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave, sa i përket deklarimit në rubrikën 3, të formularit të njoftimit "Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen" për kategorinë kandidatët për punë. Në rubrikën 4 "Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen" për të dhënat numër telefoni, e-mail, të dhënat e gjendjes civile, të dhëna biometrike (gjurmë gishtash). Në rubrikën 5 "Të dhënat sensitive që përpunohen" për të gjitha kategoritë e të dhënave sensitive. Në rubrikën 6 "Qëllimi i përpunimit" për qëllimin e menaxhimit të burimeve njerëzore. Në rubrikën 7 "Marrësi i të dhënave Personale" për të gjithë marrësit, subjekte publike dhe private në të cilat kontrolluesi në zbatim të detyrimeve ligjore si dhe të marrëveshjeve të bashkëpunimit/delegimit të përpunimit përhap të dhëna. Në rubrikën 8 "Transferimi ndërkombëtar i të dhënave" për transferimin e të dhënave drejt Italisë. Në rubrikën 9 "Mjetet e përpunimit të të dhënave" për përpunimin e të dhënave në mënyrë mekanike/manuale.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për përditësimin e ndryshimit të gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep ligji.

10. Kontrolluesi ka hartuar "Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale", por përmbajtja e saj është e kufizuar dhe nuk reflekton detyrimet ligjore sipas kategorive specifike të të dhënave personale që përpunon kontrolluesi dhe kategorive të subjekteve të të dhënave (deklaruar në Formularin e Njoftimit), në referim të parimeve ligjore dhe rregullave specifike të parashikuara në udhëzimet specifike të miratuara nga Zyra e Komisionerit. Ajo nuk reflekton të gjitha proceset përpunuese.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një "Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale", në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjekti të dhënash), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim mjaft i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, pasi shmanget pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave. Kjo rregullore duhet të jetë gjithëpërfshirëse, duke

përfshirë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale të kontrolluesit për çdo kategori subjektsh të të dhënave, sipas deklarimeve në "Formularin e Njoftimit".

Gjithashtu, kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Zyra e Komisionerit vlerëson se, në referim të kreut IV, të Udhëzimit nr. 47, datë 14.09.2018, për "Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha", është e nevojshme, që në cilësinë e kontrolluesit, me qëllim garantimin efektiv të detyrimeve ligjore dhe zbatimit të tyre në praktikë, të ndërmerren masa në kuadër të trajnimit të stafit që ka akses dhe përpunon të dhëna personale.

11. Kontrolluesi nuk kishte hartuar dhe nënshkruar "deklaratën e konfidencialitetit" me punonjësit në zbatim të nenin 28 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
12. Kontrolluesi "ASSIST SH.P.K" bën pjesë në kategorinë e kontrolluesve të mëdhenj në kuptim të Udhëzimit të Komisionerit nr. 47, datë 14.09.2018, për "Përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha".

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të natyrës së veçantë të aktivitetit që ushtron dhe masave të shtuara të sigurisë që ky i fundit kërkon në aspekt të mbrojtjes së të dhënave, kontrolluesi në fjalë, me qëllim garantimin e këtij niveli sigurie duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin 48 datë 14.09.2018 "Për certifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre" duke certifikuar sistemin e sigurisë së menaxhimit të të dhënave në përputhje me kërkesat e këtij të fundit.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin (datë 19.04.2019), si dhe në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", në datën 07.05.2019, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit, është mbajtur seanca dëgjimore.

Në seancën dëgjimore përfaqësuesit e kontrolluesit, paraqitën pretendimet të përmbledhura dhe prova në drejtim të rekuperimit të mangësive të konstatuara gjatë hetimit administrativ, si më poshtë:

- Lidhur me përpunimin e të dhënave të kandidatëve për punë nëpërmjet sistemit elektronik "Directch", "ASSIST SH.P.K" ka filluar procedura për zgjidhjen e kontratës me përpunuesin kompaninë "Manpower" S.r.l dhe brenda muajit Maj 2019 do të përfundojë procesi i fshirjes së të dhënave për këtë kategori subjektsh.
- Lidhur me deklaratën e informimit/pëlqimit për mbledhjen/përpunimin e të dhënave sensitive janë marrë masa për heqjen nga kjo deklaratë të këtij parashikimi.

- Lidhur me politikat e privatësisë në faqen online www.assist.com.al, në kuadër të detyrimit për informim "ASSIST SH.P.K" ka marrë masa dhe është duke hartuar politikën e privatësisë.
- Lidhur me delegimin e shërbime kanë filluar bisedimet me kompanitë përpunuese të të dhënave për nënshkrimin e kontratave të veçanta në përputhje me nenin 20 të ligjit.
- Lidhur me përditësimin e deklarimit nëpërmjet formularit të njoftimit për ndryshim të gjendjes së njoftimit të përpunimit të të dhënave "ASSIST SH.P.K" ka depozituar sot deklaratën e ndryshimit.
- Lidhur me të dhënat sensitive shëndetësore të punonjësve janë marrë masa për garantimin e sigurisë së tyre nëpërmjet transferimit të kartelave shëndetësore në zyrën e kyçur të arkivit.
- Lidhur me "Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale" "ASSIST SH.P.K" është duke kryer ndryshimet në rregullore.
- Lidhur me deklaratën e konfidencialitetit ka filluar procesi i nënshkrimit të saj me çdo punonjës.
- Lidhur me sistemin e kamerave në ambientet e punës së punonjësve, qëllimi i tyre është për të parandaluar një kërcënim të dukshëm të dhunës në lidhje me punën e punonjësve.
- Lidhur me tabelat informuese mbi prezencën e sistemit të kamerave të survejimit "ASSIST SH.P.K" ka filluar vendosjen e këtyre tabelave sipas standartit të miratuar me Udhëzimin e Komisionerit nr.3, datë 05/03/2010 mbi "Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", i ndryshuar.
- Lidhur me trainimin e punonjësve "ASSIST SH.P.K" do të ndërmarrë masa në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale.

Lidhur me pretendimin e paraqitur me shkrim nga kontrolluesi mbi sistemin e kamerave në ambientet e punës së punonjësve, Zyra e Komisionerit vlerëson se monitorimi nëpërmjet kamerave në ambientet e punës së punonjësve çënon privatësinë e punonjësve dhe është në kundërshtim me parimin e mjaftueshmërisë (neni 5 i ligjit) pasi kamerat duhet të konsiderohen si mjeti i fundit për të realizuar qëllimin (garantimin e sigurisë).

Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e kontrolluesit me grupin e kontrollit administrativ, reagimin e tij për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe ndalon mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 18, 20, 21, 27, 29, 30, 31 pika 1 gërma a/1 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi **ASSIST SH.P.K**, të realizojë shkatërrimin e të dhënave sensitive që zbulojnë origjinën racore ose etnike, opinionet politike, bindjet fetare ose filozofike,

të dhëna gjenetike dhe orientimin seksual, të cilat janë mbledhur në tejkalim të qëllimit të përpunimit.

2. Kontrolluesi **ASSIST SH.P.K.** në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të marrë masa për hartimin dhe vendosjen e politikave të privatësisë në faqen online www.assist.com.al.
3. Kontrolluesi **ASSIST SH.P.K.** në zbatim të nenit 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të ketë në vëmendje përmbushjen në vazhdim të detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe masat e sigurisë;
4. **ASSIST SH.P.K.** në cilësinë e kontrolluesit, të përfshijë në marrëveshjet me përpunuesit, detyrimet sipas parashikimeve të nenit 20 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.
5. **ASSIST SH.P.K.** në cilësinë e kontrolluesit, të ketë në vëmendje për raste të tjera të ngjashme, përfshirjen në marrëveshjet me përpunuesit detyrimet sipas parashikimit të nenit 20 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar.
6. Kontrolluesi **ASSIST SH.P.K.**, në zbatim të nenit 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të njoftojë Komisionerin për qëllimin dhe arsyet e mbledhjes dhe përdorimit të të dhënave biometrike, masat e sigurisë dhe kohën e ruajtjes së tyre, marrësit dhe kategoritë e marrësve të të dhënave biometrike.
7. Kontrolluesi "**ASSIST SH.P.K.**", në zbatim të neneve 21 dhe 22 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, të ketë në vëmendje përditësimin e formularit të njoftimit, për të gjitha ndryshimet e mundshme në përpunimin e të dhënave personale në vazhdimësinë e aktivitetit të tij.
8. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar, të hartohet rregullorja e brendshme, në të cilën të parashikohen masat konkrete organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e aksesit në të dhëna, të drejtat e subjekteve të të dhënave, afatet për mbajtjen e të dhënave, etj.
9. Kontrolluesi **ASSIST SH.P.K.**, të rishikojë procesin e përpunimit nëpërmjet sistemit të kamerave CCTV, të vendosura në ambientet e brendshme nëse ka mënyra të tjera për të arritur qëllimin, në mënyrë që përpunimi mos të jetë në tejkalim të qëllimit.
10. Kontrolluesi **ASSIST SH.P.K.**, me qëllim garantimin efektiv të detyrimeve ligjore dhe zbatimit të tyre në praktikë, të ndërmarrë masa në kuadër të trajnimit të stafit që ka akses dhe përpunon të dhëna personale.

11. Kontrolluesi **ASSIST SH.P.K.**, për shkak të natyrës së veçantë të aktivitetit që ushtron, duhet të marrë masat e nevojshme duke çertifikuar sistemet e menaxhimit të sigurisë së informacionit, të të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre.
12. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikën 1 të këtij Rekomandimi brenda 10 ditëve, pikat 2, 4, 6, 8 dhe 10 brenda 30 ditëve, ndërsa për pikën 11 brenda 90 ditëve nga marrja dijani e këtij akti, dhe të njoftojë me shkrim Zyrën e Komisionerit për masat e marra. Përbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.
13. Në rast mos përbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 24.5.2019

KOMISIONERI
Besnik Dervishi

